



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA SHTETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE	
DRZAVNA AGENCIJA ZA ZASTITU LICNIH PODATAKA	
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA	
ZYRA E ARKIVIT - KANCELARIA DRHIVA - ARHITEKTURA	
Nr. Org. Org. Jeta Org. Ubra	01
Nr. Prot. Ho. Prot. Prot. No.	83
Nr. i tagjeve Dety. shtrimit No. pages	04
26 11 14	

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Drzavna Agencija za Zastitu Licnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

Nr. 83 /14
Datë: 26.11.2014

Në mbështetje të nenit 49, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 dhe 1.3 të Ligjit nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Zv. Mbikqyrësi Kryesor Shtetëror (në tekstin e mëtejme "Mbikqyrësi") i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejme "Agjencia") merr këtë

VENDIM

1. Urdhërohet Spitali për Gjinekologji dhe Infertilitet "Bahçeci" (në tekstin e mëtejme Spitali "Bahçeci"), me adresë Magjistralja Prishtinë Shkup Km. i 9-të, me nr. të regjistrimit të biznesit 70610515, të ndalojë përkohësisht përpunimin e të dhënave personale për Frytnimin e Asistuar Mjekësor deri në klasifikimin dhe marrjen e masave për sigurinë e të dhënave personale.
2. Urdhri për ndalimin e përkohshëm të përpunimit të të dhënave personale sipas pikës 1 të këtij Vendimi mbetet në fuqi për aq kohë sa kërkohet për të siguruar që të dhënat personale për Frytnimin e Asistuar Mjekësor (në tekstin e mëtejme FAM) janë duke u përpunuar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, përkatësisht deri në njoftimin nga Spitalit Bahçeci për nxjerrjen e masave dhe procedurave për sigurinë dhe klasifikimin e të dhënave personale.
3. Spitali „Bahçeci “ ka për detyrë që brenda 8 (tetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit ta zbatojë atë dhe të njoftojë Agjencinë për zbatimin e tij.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.

ARSYETIM

Vendimi është i mbështetur në faktet dhe normat ligjore si në vijim.

Inspektimi në Spitali "Bahçeci" është realizuar sipas detyrës zyrtare pas pranimit të ankesës lidhur me shqetësimet e ngritura për përpunimin e të dhënave personale në Spitali „Bahçeci”.

Përmes njoftimit me shkrim të datës 29.09.2014 me nr. protokollin nr. 180 Spitali Bahçeci është njoftuar për fillimin e inspektimit nga ana e Mbikëqyrësit dhe zyrtarët mbështetës. Inspektimi në Spitalin „Bahçeci” ka filluar me datë 29.09.2014 dhe ka përfunduar me 30.09.2014.

Me qëllim të mbikëqyrjes së ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale, bazuar në dispozitat e ligjeve të aplikueshme në sektorin e shëndetësisë dhe të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejme LMDHP Ligji nr. 03/L-172), është hartuar lista e dokumenteve të nevojshme me rastin e përpunimit të të dhënave personale nga ana e Spitalit „Bahçeci”.

1. Spitalit „Bahçeci” nuk ka akt të i brendshëm që rregullon përpunimin e të dhënave personale.

Në pajtim me nenin 3 paragrafi 1, të LMDHP-së të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme dhe të ligjshme pa e cenuar dinjitetin e subjektit të të dhënave. Çdo kontrollues i cili synon përpunimin e të dhënave personale që nënkupton një apo sërë veprimesh që kryhen në të dhëna personale duke përfshirë grumbullimin, regjistrimin, organizimin ruajtjen, bllokimin, asgjësimin apo shkatërrimin duhet të ketë një akt të brendshëm përmes të së cilit bën rregullimin e këtyre veprimeve respektivisht përpunimin e të dhënave personale bazuar në legjislacionin në fuqi në pajtim me parimet e përpunimit të të dhënave personale.

Mungesa e aktit të brendshëm në Spitalin „Bahçeci” ka sjellë deri tek krijimi i sistemit të dosjeve të subjekteve të të dhënave në kundërshtim me parimet e përpunimit të të dhënave personale, duke krijuar me këtë rast sisteme të dosjeve të përbashkëta, edhe pse të dhënat personale të grumbulluara kanë baza ligjore të ndryshme të përpunimit, bazuar në shërbimet e ndryshme të ofruara nga Spitali „Bahçeci”.

Spitali „Bahçeci” duhet të ketë akt të brendshëm për çdo shërbim të ofruar, nga se baza ligjore e përpunimit të të dhënave personale ndryshon. Konkretisht bazë ligjore e përpunimit të të dhënave personale për FAM është Udhëzimi Administrativ për Frytnimin e Asistuar Mjekësor Nr. 06/2013 (në tekstin e mëtejme UA FAM).

2. Spitali Bahçeci nuk ka bërë klasifikimin e të dhënave personale.

Në pajtim me nenin 2 paragrafi 1 nënparagrafi 1.16 të LMDHP-së, të dhënat për gjendjen shëndetësore janë të dhëna të ndjeshme. Të dhënat personale të ndjeshme në pajtim me nenin 2 paragrafi 1, nënparagrafi 1.14 duhet klasifikuar me qëllim të shënimit për të treguar natyrën e tyre të ndjeshme.

Në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i UA FAM-it si dhe nenit 7 paragrafit 1 të LMDHP-së të dhënat personale të përpunuara nga institucioni shëndetësor Spitali „Bahçeci” duhet mbrojtur në mënyrë të veçantë dhe të klasifikohen me qëllim të parandalimit të qasjes dhe përdorimit të paautorizuar.

3. Spitali „Bahçeci” nuk ka akt të brendshëm për marrjen e masave për sigurimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Në pajtim me nenin 14 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 dhe 1.3 të LMDHP-së, Spitali „Bahçeci” duhet të marrë masat e duhura organizative teknike dhe logjiko-teknike për mbrojtjen dhe sigurimin e të dhënave personale duke mbrojtur lokalet, pajisjet, sistemet aplikative duke parandaluar çfarëdo qasje të paautorizuar përfshirë këtu edhe kontrollin e qasjes.

Në spitalin „Bahçeci” dosjet fizike dhe elektronike të të gjithë subjekteve/pacientëve të të dhënave trajtohen njëloj dhe gjinden në të njëjtin vend. Dosjet fizike të subjekteve/pacientëve janë në të vendosura në katin përdhës të objektit të Spitalit „Bahçeci”, në hapësirat e shfrytëzuara nga punëtorët shëndetësorë /receptionistët e Spitalit „Bahçeci”. Hapësirat ku janë të vendosura dosjet nuk janë të mbyllura. Vitrinat ku janë të vendosura dosjet nuk janë të mbyllura. Qasje në dosjet e pacientëve për FAM kanë punëtorët shëndetësorë të spitalit pa ndonjë kriter të veçantë.

4. Spitali „Bahçeci” nuk ka marrë masat për ruajtjen e konfidencialitetit.

Në pajtim me neni 14 paragrafi 4 i LMDHP-së dhe nenin 20 paragrafi 1 Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetareve në Kujdesin Shëndetësor, stafi shëndetësor dhe të gjithë të punësuarit të cilët kanë qasje në të dhënat personale duhet ruajtur fshehtësinë e të dhënave personale me të cilën ata njihen gjatë dhe pas përfundimit të punës së kontraktuar, duke garantuar me këtë rast ruajtjen e konfidencialitetit dhe privatësinë e të dhënave të ndërlidhura me trajtimin nga ana e institucionit shëndetësor.

Stafi shëndetësor dhe të punësuarit e tjerë në spitalin „Bahçeci” nuk kanë të nënshkruar deklaratën e konfidencialitetit apo marrëveshjen për mos zbulimin e të dhënave.

5. Spitali „Bahçeci” nuk ka marrë masat për parandalimin e shkatërrimi të të dhënave personale.

Në pajtim me nenin 14 paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 i LMDHP-së, Spitali „Bahçeci” nuk ka marrë masa duhura për parandalimin, shkatërrimin, fshirjen e të dhënave personale të përpunuara në kopje fizike dhe elektronike.

Në pajtim me nenin 3 paragrafi 5 i LMDHP-së të dhënat personale mund të ruhen vetëm për aq kohë sa është e nevojshme për arritjen e qëllimit për të cilin janë grumbulluar ose përpunuar më tutje. Me rastin e përmbyshjes së qëllimit të përpunimit, të dhënat personale do të asgjësohen, fshihen, shkatërrohen, bllokohen ose bëhen anonime, përveç nëse është paraparë ndryshe me Ligjin për Lëndën Arkivore dhe Arkivat ose me ndonjë ligj tjetër përkatës. Bazuar në UA FAM neni 43 paragrafi 3, institucioni shëndetësor obligohet që të dhënat nga paragrafi 1, i këtij neni ti ruajë tridhjetë (30) vite nga dita e evidentimit.

Bazuar në UA FAM neni 43 paragrafi 3 Spitali „Bahçeci” obligohet që të dhënat personale të subjekteve të të dhënave në kuadër të FAM-it ti ruajë tridhjetë (30) vite nga dita e evidentimit.

Spitalin „Bahçeci” ka të ruajtur në formën fizike dosje të subjekteve të të dhënave nga vitit 2012, ndërsa në formë elektronike janë të ruajtura nga vitit 2011.

Mungojnë dosjet e personelit shëndetësor të cilët nuk janë më të punësuar pran Spitalit „Bahçeci”

6. Spitali „Bahçeci” nuk ka të emëruar në formë të shkruar personin/personat kompetent që janë përgjegjës për sistemin e dosjeve.

Në pajtim me nenin 16 të LMDHP-së Spitali „Bahçeci” duhet të kujdeset në çdo kohë që të dhënat personale janë të mbrojtura sipas mënyrës së caktuar të përshkruar në aktet e tyre të brendshme. Të vendos procedurat dhe masat dhe të emëroj personat përgjegjës për përkujdesjen dhe implementimin e këtyre masave.

Spitali „Bahçeci” nuk ka emëruar personat përgjegjës për sistemin e dosjeve.

Fakt është Spitali „Bahçeci” nuk ka akt të brendshëm që rregullon përpunimin e të dhënave personale përmes së cilës do të krijonte katalogun e sistemit të dosjeve në pajtim me nenin 17 të LMDHP-së dhe duke bërë shkelje për moslajmërimin e krijimit të sistemit të dosjeve në pajtim me nenin 18 të LMDHP-së.


Fakt është që Spitali „Bahçeci” nuk a bërë klasifikimin e të dhënave personale; nuk ka asnjë akt të brendshëm (politikat e sigurisë, procedurat, standardet e operimit etj.) për marrjen e masave për sigurinë e të dhënave personale; stafi shëndetësor në Spitalin „Bahçeci” nuk ka të nënshkruar deklaratën e konfidencialitetit; nuk ka marrë masat për parandalimin e shkatërrimi të të dhënave personale dhe nuk ka të emëruar në formë të shkruar personin/personat kompetent që janë përgjegjës për sistemin e dosjeve në pajtim me normat ligjore të LMDHP-së, Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetareve në Kujdesin Shëndetësor dhe UA FAM.


Faktet si më sipër arsyetojnë marrjen e masave si në dispozitiv. Në bazë të nenit 49 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe 1.3 Mbikëqyrësi ka të drejtë që të ndalojë përkohësisht dhe në mënyrë të caktuar përpunimin e të dhënave personale, anonimizimin, klasifikimin dhe bllokimin e të dhënave personale saher që konkludon se të dhënat personale janë duke u përpunuar në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Këshillë Juridike

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankimi administrativ, por mund të fillohet konflikti administrativ pranë gjykatës kompetente në afatin prej 30 ditëve.

Zv. Mbikqyrës Kryesor Shtetëror


Mentor Hoxhaj



Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- Spitalit „Bahçeci”
- Ministrisë së Shëndetësisë
- Arkivit të Agjencisë